

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 9, paragrafët 1 dhe 2, si dhe nenit 49 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së nr. 275, date 30.12.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur më 06.06.2026, nxjerr këtë:

**Oda e Farmacistëve të Kosovës**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

Nr. 126      Datë 06/06/26

### VENDIM

- I. Hapet periudha e kandidimit për Kryetar të Odës së Farmacistëve të Kosovës.
- II. Kandidatët për Kryetar të OFK-së duhet të plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë në listën e certifikuar të anëtarëve të Kuvendit të OFK-së për mandatin 2026–2030;
2. Të kenë mbështetjen e të paktën dhjetë (10) anëtarëve të Kuvendit të OFK-së. Një anëtar i Kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidat, ndërsa kandidati për Kryetar nuk mund të japë nënshkrim mbështetës për veten;
3. Të kenë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në fushën e farmacisë;
4. Të mos jenë të dënuar për shkelje të Kodit të Etikës dhe për veprë penale;
5. Të mos jenë persona të zgjedhur apo të emëruar në funksione tjera publike dhe politike, përveç funksioneve profesionale mjekësore dhe në mësimdhënie.

III. Kandidatura për Kryetar duhet të përmbajë këtë dokumentacion:

- a. Aplikacionin e përcaktuar nga KQZ;
- b. CV-në dhe programin e kandidatit për Kryetar;
- c. Kopjen e licencës së punës;
- d. Vërtetimi i Kodit Etik
- e. Certifikata mbi dënimin penal nga gjykata nuk kërkohet për shkak se të njëjtët e kanë dorëzuar me aplikimin për anëtar Kuvendi.
- f. Deklaratën mbi konfliktin e interesit dhe deklaratën nën betim se kandidati nuk është person i zgjedhur apo i emëruar në funksione tjera publike dhe politike, përveç funksioneve profesionale mjekësore dhe në mësimdhënie.

IV. Kandidatura dorëzohet fizikisht në zyrat e OFK-së, nga data 06.06.2026 deri më 11.06.2026, nga ora 08:30 deri në ora 15:30.

V. Aplikacioni i kandidimit, deklarata mbi konfliktin e interesit dhe deklarata nën betim si dhe rregullat e sjelljes të miratuar në KQZ i bashkëngjiten këtij vendimi.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### I dërgohet:

- Anëtarëve të certifikuar të Kuvendit;
- Sekretariatit të KQZ-së.

Kryetari i KQZ-së

*fu* Mr. Ph. Betim Ramadani



Faqe 1 nga 1

**APLIKACIONI PËR KANDIDIM PËR KRYETAR/E/E TË OFK-së  
TË DHËNAT E KANDIDATIT/ES**

<b>Emri</b>		<b>Data e lindjes</b>	
<b>Mbiemri</b>		<b>Nr. Licencës</b>	RKS-
<b>Nr. kontaktues</b>		<b>E-mail</b>	

\* Me nënshkrimin tim deklaroj se të gjitha të dhënat e paraqitura në këtë aplikacion janë të sakta dhe të vërteta, si dhe mbaj përgjegjësi ligjore për saktësinë dhe vërtetësinë e tyre. Gjithashtu, deklaroj se jam i/e njoftuar me procedurën, rregullat zgjedhore dhe rregullat e sjelljes zgjedhore, si dhe me pasojat që mund të rrjedhin nga mosrespektimi i tyre, përfshirë iniciimin e procedurave disiplinore, penale dhe/ose diskualifikimin nga gara zgjedhore, sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja.

Nënshkrimi i kandidatit/es\* \_\_\_\_\_

**TË DHËNAT MBI MBËSHTETËSIT**

<b>Nr.</b>	<b>Anëtari i Kuvendit (Emri dhe Mbiemri)</b>	<b>Nënshkrimi</b>	<b>Data e nënshkrimit</b>
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			
9.			
10.			

**\*Deklarata e mbështetësve**

*\*Deklaroj se jam anëtar/e i/e certifikuar i/e Kuvendit të Odës së Farmacistëve të Kosovës për mandatin 2026–2030 dhe se mbështetjen për kandidatin/en për Kryetar/e të OFK-së e kam dhënë me vullnetin tim të lirë, pa in nënsbtruar asnjë forme presioni, ndikimi të padrejtë, kërcënimi apo kushtëzimi. Gjithashtu, deklaroj se kam mbështetur vetëm një kandidat/e për Kryetar/e të OFK-së dhe jam i/e vetëdijshëm/e për përgjegjësitë që rrjedhin nga deklarimi i të dhënave të pavërteta.*

## DEKLARATË MBI KONFLIKTIN E INTERESIT DHE DEKLARATË NËN BETIM

Unë, i nënshkruari/a \_\_\_\_\_, me numër licence profesionale \_\_\_\_\_, kandidat/e për **Kryetar/e të Odës së Farmacistëve të Kosovës**, në përputhje me nenin 49 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së nr. 275, datë 30.12.2024, jap këtë:

### DEKLARATË

Deklaroj se:

1. Nuk ndodhem në situatë konflikti interesi që do të ndikonte ose mund të ndikonte në ushtrimin e paanshëm, të pavarur dhe profesional të funksionit të Kryetar/eit të Odës së Farmacistëve të Kosovës.
2. Nuk kam interesa personale, financiare, profesionale apo interesa të tjera që bien ndesh me interesat dhe misionin e Odës së Farmacistëve të Kosovës.
3. Do të njoftoj menjëherë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe organet kompetente të OFK-së për çdo rrethanë që mund të paraqesë konflikt interesi gjatë procesit zgjedhor ose gjatë ushtrimit të mandatit.

### DEKLARATË NËN BETIM

Po ashtu, nën përgjegjësi të plotë morale, profesionale dhe ligjore, deklaroj se:

1. Nuk jam person i zgjedhur apo i emëruar në funksione publike ose politike.
2. Nuk ushtroj dhe nuk mbaj asnjë funksion politik në nivel qendror apo lokal.
3. Përfshirë nga pika 1 dhe 2 përbëjnë vetëm funksionet profesionale shëndetësore dhe funksionet në mësimdhënie, të cilat lejohen sipas legjislacionit në fuqi.
4. Të gjitha të dhënat e paraqitura në këtë deklaratë janë të sakta, të vërteta dhe të plota.

Jam i/e vetëdijshëm/e se paraqitja e të dhënave të pavërteta në këtë deklaratë përbën bazë për refuzimin e kandidaturës, anulimin e mandatit dhe marrjen e masave të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

**Emri dhe Mbiemri:** \_\_\_\_\_

**Nr. i Licencës:** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi:** \_\_\_\_\_

**Vendi:** \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2026

## **NJOFTIM**

### **Për rregullat e sjelljes zgjedhore gjatë periudhës së kandidimit për Kryetar/e të Odës së Farmacistëve të Kosovës**

Të gjithë kandidatët për Kryetar/e të Odës së Farmacistëve të Kosovës, mbështetësit e tyre, anëtarët e Kuvendit, votuesit dhe vëzhguesit njoftohen se gjatë periudhës zgjedhore janë të obliguar të respektojnë rregullat dhe standardet e sjelljes zgjedhore, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i OFK-së, si dhe aktet tjera në fuqi që rregullojnë procesin zgjedhor.

Gjatë periudhës së kandidimit për Kryetar/e, mbledhjes së nënshkrimeve mbështetëse, fushatës zgjedhore dhe ditës së votimit, të gjithë pjesëmarrësit në proces duhet të veprojnë në përputhje me parimet e ligjshmërisë, barazisë, transparencës, paanshmërisë dhe integritetit të procesit zgjedhor.

Mbështetësit e kandidatëve për Kryetar/e duhet të jenë anëtarë të certifikuar të Kuvendit të Odës së Farmacistëve të Kosovës për mandatin 2026–2030. Çdo anëtar i Kuvendit mund të mbështesë vetëm një kandidat për Kryetar/e të OFK-së. Kandidati për Kryetar/e nuk mund të japë nënshkrim mbështetës për vetveten.

Ndalohet çdo veprim që cenon lirinë e kandidimit, lirinë e mbështetjes, lirinë e votimit, fshehtësinë e votës apo rregullsinë e procesit zgjedhor. Në veçanti, ndalohet ushtrimi i presionit, ndikimit të padrejtë, kërcënimit apo kushtëzimit ndaj anëtarëve të Kuvendit, kandidatëve, mbështetësve, votuesve apo vëzhguesve; sigurimi i nënshkrimeve mbështetëse përmes mashtrimit, detyrimit apo premtimeve të përfitimeve; ofrimi i shpërblimeve apo përfitimeve për sigurimin e mbështetjes ose votës; përdorimi i gjuhës fyese, kërcënuese apo nxitëse të urrejtjes; pengimi i punës së KQZ-së apo organeve tjera përgjegjëse për administrimin e procesit; si dhe çdo veprim tjetër që cenon rregullsinë, barazinë ose rezultatin e procesit zgjedhor.

Vëzhguesit kanë të drejtë të përcjellin procesin zgjedhor vetëm në përputhje me autorizimin e dhënë. Atyre u ndalohet ndërhyrja në proces, ndikimi të anëtarët e Kuvendit apo pengimi i mbarëvajtjes së procesit zgjedhor.

Çdo pretendim për shkelje të këtyre rregullave duhet të paraqitet në KQZ, jo më vonë se 24 orë nga momenti i pretendimit për shkelje. Ankesa duhet të përmbajë përshkrimin e shkeljes së pretenduar dhe dëshmitë përkatëse, kur ato ekzistojnë.

Në rast të konstatimit të shkeljeve, KQZ-ja mund të ndërmarrë dhe të iniciojë masa përkatëse, përfshirë masa etike dhe disiplinore, refuzimin ose diskualifikimin e kandidaturës nga procesi zgjedhor, si dhe iniciimin e procedurave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Ky njoftim i bashkëngjitet formularit të kandidimit për Kryetar/e të OFK-së dhe shërben për informimin e kandidatëve, mbështetësve të tyre, anëtarëve të Kuvendit dhe vëzhguesve lidhur me rregullat e sjelljes zgjedhore gjatë periudhës zgjedhore.